



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:189374
Datë: 20.06.2024
Numri i dokumentit: 05842578

AA.nr.655/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Delushe Halimi anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, Xh.B nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson, Armend Deskaj, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me seli në Prishtinë dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit, përkitazi me ankesën e paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2300/2020, të datës;04.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë;13.06.2024, merr këtë,

A K T V E N D I M

Miratohet si e bazuar ankesa e paditësit, Xh.B nga Prishtina, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2300/2020, i datës;04.07.2023, prishet dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2300/2020, të datës;04.07.2023, është vendosur, “*I. REFUZOHET si e pabazuar padia dhe kërkesëpadija e paditësit Xh.B nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Armend Deskaj, avokat nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi A.nr.458/2019 i datës 03.12.2020 i të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.*”

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë paditësi, përmes të autorizuarit të tij, Armend Deskaj, avokat nga Prishtina, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të anulohet, dhe çështja ti kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim, apo të njëjtën ta ndryshon dhe të aprovon në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

Përgjigje në ankesë nuk kanë paraqitur palët e paditura.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 paragrafi c) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka gjetur se ankesa e paditësit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datë:31.12.2020, kundër vendimit të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në Prishtinë, sepse konsideron se vendimi i kundërshtuar me padi është i pa bazë dhe jo i ligjshëm, për arsye se nuk është vlerësuar drejtë gjendja faktike nga ana e organeve administrative, si dhe është zbatuar gabimisht edhe ligji material, me propozim që i njëjti të anulohet si i kundërligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër vendimit të paditurit, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës për shqyrtim kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar, me arsyetim se “Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi si dhe propozimin e paditësit për anulimin e të njëjtit, në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Gjykata gjeti se si i padituri drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e rishqyrtimit të ankesës së paditësit. Gjykata konstatoi se procedura administrative tek i padituri, është zhvilluar në përputhje të plotë me nenin 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Gjykata po ashtu gjeti se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe me të drejtë janë trajtuar të gjitha pretendimet ankimore të paditësit. Gjykata konstatoi se vendimi i të paditurit nuk është në kundërshtim me nenin 48 të LPA-së, për faktin që nga vlerësimi dhe analizimi i pjesës arsyetuese, gjykata erdhi në përfundim se në pjesën arsyetuese janë dhënë sqarime të detajuara edhe të dispozitave ligjore mbi të cilat është marrë vendimin i kundërshtuar me padi. Në këtë drejtim, gjykata gjeti se vendimi i atakuar i marrë nga i padituri është në përputhje të plotë me nenin 47, paragrafin të LPPA-së në të cilin përcaktohet: “Neni 47-Struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar. 1. Akti administrativ i shkruar përmban:1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes;1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit.1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin);1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrative apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë. Gjykata poashtu gjeti se pjesa arsyetuese e vendimit është në përputhje me nenin 48 të LPPA-së i cili përcakton: “Neni 48-Arsyetimi i një akti administrativ me shkrim. 1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:1.1.paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës;1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret;1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga

pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij. Gjykata vërtetoi gjetjet e të paditurit në vendimin e kontestuar dhe konstatoi se i padituri me të drejtë ka konstatuar gjendjen faktike të vërtetuar. Gjykata gjeti se vendimi i goditur me padi nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave procedurale, për faktin që organi i paditur, e ka shqyrtuar ankesë, e ka dërguar për përgjigje tek Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, pastaj ka administruar provat e siguruara dhe ka nxjerrë vendim të ligjshëm, pra nuk ka bërë shkelje të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Në kuptim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike, gjykata gjeti se organi i paditur me të drejtë kishte konstatuar se Ministria përgjegjëse për administratë publike në shkresën e datës 13.06.2011 kishte vlerësuar se koeficienti 8 ishte ekuivalent me detyrat dhe përgjegjësitë në këtë vend të punës dhe nuk ka bazë për ngritje të koeficientit të pagës. Gjykata po ashtu gjeti se risistemimi i paditësit nga pozita e Bashkëpunëtor për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Veprimtari Botuese në pozitën e Zyrtarit të lartë të Komunikimit dhe Përkthyes, ishte bërë në pajtim të plotë me Rregulloren Nr.319/1 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës si dhe në pajtim të plotë me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 32, paragrafin 1 të këtij Ligji. Duke u bazuar në këto prova dhe në dispozitat e sipërcituara, gjykata vlerësoi se vendimi i goditur me padi është i drejtë dhe i bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike e juridike.”

Kolegji i Gjykatës të Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe pas ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar, dhe shkresave të tjera të lëndës, e duke i pasur parasysh edhe pretendimet ankimore, vëren se aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) dhe neni 183 të LPK-së, se është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij për çka në mënyrë të bazuar theksohet në ankesë. Prandaj pikëpamjet juridike të Gjykatës së shkallës së parë nuk mund ti përkrahë si të rregullta dhe të ligjshme për arsye se, arsyet në të cilat bazohen faktet vendimtare lidhur me mënyrën e vendosjes, janë jo të qëndrueshme dhe në kundërshtim me faktet të cilat paditësi i thekson në ankesë. Kjo për faktin se Gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, duke mos dhënë asnjë vlerësim lidhur me pretendimin e paditësit në padi dhe në seancën e shqyrtimit kryesor, “*Se ASHAK-u e ka ndërruar kontratën pas tre muajsh arbitrarisht (prej koeficionetit 9 në 8) dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore meqë kjo çështje e (ndërrimi i kontratës koeficientit) kërkon zhvillimin e procedurave (formimin e komisionit për trajtimin e çështjes, vendim përkatës...) kjo nuk është bërë nga ASHAK-u andaj çdo hap i ndërmarrë nga ASHAK-u për zvogëlimin e koeficientit është në kundërshtim me dispozitat ligjore: kjo argumentohet edhe në një letërkëmbim (korrespondence) me sekretaren e ASHAK-ut znj. P... para pak kohe në të cilin email znj. P... pranon se duhet ndjekur disa procedura në raste të tilla. Provë email”*, e për të cilën pretendim të paditësit, nuk e ka vlerësuar fare Gjykata e shkallës së parë, kurse ky pretendim ka qenë fakt vendimtar që kjo çështje të gjykohej në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sipas vlerësimit të kolegjit të apelit dhe bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, dhe të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nga Gjykata kërkohen që të shqyrtojnë dhe të japin përgjigje specifike dhe të qarta në lidhje me pretendimet dhe argumentet thelbësore të palëve (shih, rastet e GJEDNJ-së, Buzescu kundër Rumanisë, rasti, Donadze kundër Gjeorgjisë, rastin, Ruiz Torija kundër Spanjës dhe rasti, Hiro Balani kundër Spanjës si dhe rasti i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës KI227/19 me parashtues N.T. “Spahia Petrol”). Prandaj kolegji i apelit vlerëson se përtej citimit të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkundër pretendimit kryesor të paditësit në padi

dhe në seancën e shqyrtimit kryesor, për të cilin pretendim paditësi ka kërkuar nga Gjykata që të vlerësoj, vërtetoj, “*Se ASHAK-u e ka ndërruar kontratën pas tre muajsh arbitrarisht (prej koeficientit 9 në 8) dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore meqë kjo çështje (ndërrimi i kontratës koeficientit) kërkon zhvillimin e procedurave (formimin e komisionit për trajtimin e çështjes, vendim përkatës...)* kjo nuk është bërë nga ASHAK-u andaj çdo hap i ndërmarrë nga ASHAK-u për zvogëlimin e koeficientit është në kundërshtim me dispozitat ligjore: kjo argumentohet edhe në një letërkëmbim (korrespondence) me sekretaren e ASHAK-ut znj. P... para pak kohe në të cilin email znj. P... pranon se duhet ndjekur disa procedura në raste të tilla. Provë email”, Gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë asnjë vlerësim lidhur me këtë pretendim, e i cili pretendim ka qenë vendimtar që në këtë rast iu ka referuar paditësi edhe me ankesë. Në këtë kuptim kolegji i apelit vlerëson se drejtësia procedurale kërkon që pretendimet thelbësore të ngritura nga palët në Gjykatë duhet dhënë përgjigje në mënyrën e duhur, posaçërisht nëse kanë të bëjnë me pretendime vendimtare.

Prandaj, aktgjykimi i kontestuar në rastin konkret është juridikisht i pa qartë, dhe se ka një arsytim jo të mjaftueshëm. Prandaj, kolegji i apelit tani për tani nuk mund të pranoj si të drejtë një konstatim të tillë të paraqitur në aktgjykimin e ankimuar, sepse ka të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dhe se i njëjti është juridikisht i pa qartë dhe kundërthënës me vetveten edhe arsyetimin e tij.

Për arsyet e dhëna më lart, aktgjykimi i kundërshtuar është dashur të prishet dhe çështja t’i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, për t’i mënjeluar shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) dhe neni 183 të LPK-së, që janë të tilla që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktgjykimit të goditur.

Në ri-procedurë, Gjykata e shkallës së parë duhet ti mënjanoj të metat e vërejtura sipas këtij aktgjykimi, përkatësisht të vlerësoj pretendimin se paditësit “*Se ASHAK-u e ka ndërruar kontratën pas tre muajsh arbitrarisht (prej koeficientit 9 në 8) dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore...*” të vlerësoj provat e propozuara nga paditësi për të vërtetuar një fakt të tillë, përkatësisht të vërtetoj faktin se paditësi a ka themeluar marrëdhënie punë me të paditurin e dytë sipas konkursit me koeficient 9, pastaj të vlerësoj se i padituri, a ka mundur ti ndërroj paditësit koeficientin nga nëntë (9) në tetë (8), pas themelimit të marrëdhënies së punës, dhe nëse ka mundur, a i ka ndjekur procedurat për një veprim të tillë, dhe pas vlerësimit të këtyre provave dhe veprimeve të organit të paditur lidhur me zvogëlimin e koeficientit, e duke i ndërlidhur me kërkesat e ligjit procedural dhe ligjit material, Gjykata ka mundësi të bie aktgjykim të drejtë dhe të ligjshëm në kuptim të dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligjit për Konfliktet Administrative dhe të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Mbi këtë bazë, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, si dhe nenit 195 paragrafi 1 pika c), të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.655/2023, datë;13.06.2024

Kryetari i kolegjit
Hajriz Hoti